



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E GJAKOVËS
 OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
 01 Nr. _____ /2024
 Datë. 30.05.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në Rregulloren Nr. 04/2017 mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe nenit 15 pika 1 të Rregullores 01 nr. 110/01-3560/2020 për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, të datës 30.01.2020, në mbledhjen e mbajtur me datë.30.05.2024, pas diskutimeve lidhur më pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për mbështetje Financiare për KFC “Vëllaznimi“, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim-Vendimi i Kryetarit të Komunës për mbështetje Financiare në vlerë prej 40,000 € për Klubin e Futbollit KFC “Vëllaznimi” nga Gjakova.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi të rekomanduara nga komisioni vlerësues sipas thirrjes publike për Projektet /programe të OJQ-ve në fushën e Sportit në Komunën e Gjakovës, do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të këtij Klubi.
3. Shuma e mjeteve financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi do të ndahen nga Kategoria Subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e Komunës së Gjakovës nga Kodi Buxhetor 632/22/85016, 632/22/18016 dhe 632/22/47016 në vlerë prej 40,000€.
4. Obligohen Organet e Administratës Komonale për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet Ligjore dhe nënligjore në fuqi, për ekzekutimin e mjeteve Financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
 - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
 - Klubit të Futbollit KFC “Vëllaznimi”.
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.

